



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_, datë \_\_/\_\_/2019

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1071, DATË 23.12.2015 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË MBROJTJES SOCIALE 2015-2020,  
SI DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT NË ZBATIM TË TIJ 2015-2020.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes  
Sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1071, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit dhe në paragrafin e parë, vitet nga 2015-2020 bëhen 2019 – 2022.
2. Plani i Veprimit, për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020, zëvendësohet me Planin e Rishikuar të Veprimit, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

## RELACION

### PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

### PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1071, DATË 23.12.2015 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MBROJTJES SOCIALE 2015-2020"

#### I. QËLLIMI PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Me anë të këtij projektvendimi realizohet miratimi i Dokumentit strategjik të mbrojtjes sociale dhe Planit të Rishikuar të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2015-2020 për periudhën 2019 – 2022. Rishikimi dhe shtyrja e afatit të këtij dokumenti politik ka për qëllimin vazhdimin e reformave të fushës, reflektimin e ndryshimeve që kanë ndodhur në tregun e punës gjatë 4 viteve të zbatimit të kësaj Strategjie. Qëllimi i planit të rishikuar të veprimit 2019 – 2022 është integrimi i politikave në drejtim të konsolidimit të skemës së re të NE duke prioritetizuar shenjëstrimin më të mirë të familjeve të prekura nga varfëria dhe duke i mbështetur ato nëpërmjet sigurimit të asistencës afat-shkurtër për familjet/personat në nevojë, duke bërë të mundur një kalim gradual prej politikave pasive të pagesave të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar në ato aktive stimuluese të punësimit, si dhe duke i vënë theksin e duhur zhvillimit të forcës së punës në vend.

Paketa mbështetëse me subvencione shtesë/ bonuse për vaksinimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe ofrimi i paketës së ndihmës në natyrë tregon vëmendjen e shtuar për të asistuar familjen në tërësi duke integruar të gjitha llojet e shërbimeve publike.

Pjesë e vizionit të ri të kësaj strategjie është reformimi sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i cili përfshin krijimin e një procesi të ri multidisiplinor bio-psiko-social i bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për vlerësimin në tërësi të nevojave të individit me aftësi të kufizuar dhe jo vetëm diagnostikimin tyre. Vlerësimi përfshin një paketë të plotë të integruar për PAK që nga identifikimi i sëmundshmërisë, diagnostikimi, vlerësimi sovcial i nevojave, rehabilitimi nëpërmjet shërbimeve të specializuara sociale dhe shëndetësore, deri në menaxhimin e çdo rasti për punësim dhe arsimim apo kualifikime profesionale.

Kjo strategji synon të zhvillojë një sistem të integruar funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shëndetësor që promovon zgjedhjen, pavarësinë dhe inkurajon pjesëmarrje të plotë dhe efektive në shoqëri, sipas një qasjeje të barabartë për të gjithë qytetarët që kërkojnë shërbime.

Një objektiv sfidues është krijimi i sistemit të integruar të shërbimeve shoqërore dhe shëndetësore në nivel vendor për familjen dhe individët në nevojë. Strategjia mundëson

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1071, datë 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2015-2020".

përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës të individëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

## II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti i propozuar është në harmoni me objektivat e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale duke synuar që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore, të cilat rikonceptohen me prioritet familjen dhe duke adresuar "qasjen e ciklit të jetës".

Gjithashtu SKZHI ka parashikuar drejtimet dhe objektivat kryesore, në të cilat do të zhvillohet sistemi.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të orientimeve të programit të Qeverisë dhe raportit të vlerësimit afatmesëm, ka rishikuar planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe ka shtyrë afatin e saj që do të mbulojë periudhën 2019-2022.

## III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Vizioni i Strategjisë për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 është vlerësuar të jetë i njëjtë dhe për periudhën 2019-2022 dhe konkretisht vizionin është:

*"Ndërtimi i një sistemi mbrojtjeje sociale që të luftojë pabarazitë social-ekonomike, parashikimi i një sistemi që ka politikat dhe mekanizmat për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë, ose të përjashtuar nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegritit social alternuar me skemat e punësimit."*

Në strategji janë rishikuar indikatorët deri në vitin 2022, të cilët nisen nga një bazë reale të dhënash.

Gjithashtu, në Planin e Veprimit 2019-2022 dhe Treguesit për zbatimin e saj, është detajuar buxheti i planifikuar për çdo masë, në bashkëpunim dhe me kontributin e donatorëve. Çdo masë do të realizohet nga mbështetja e parashikuar në PBA, si dhe në projektet e donatorëve, që janë duke u zbatuar, si dhe projektet e miratuara që do të fillojnë të zbatohen.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1071, datë 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2015-2020".

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR  
Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozim të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektakti nuk synon përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT  
Strategjia e Mbrojtjes Sociale bazohet në politikat për:

A. *Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë*, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, duke përmirësuar shenjëstrimin tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndhmës Ekonomike, si dhe lidhjen me skemat e punësimit, me shërbime të integruara me qëllim riintegrimin social të tyre në jetën shoqërore.

Qëllimi: Deri në vitin 2022, të ndikohet në zbutjen e varfërisë ekstreme duke rritur shenjëstrimin e individëve dhe familjeve ekstremisht të varfra, si dhe integrimin social të tyre, duke rritur në 10% pjesën e përfituesve të përfshirë në skemat e punësimit, duke e kthyer nga një skemë pasive në një skemë aktive

Qëllimet e kësaj politike sektoriale do të synohen të realizohen nëpërmjet përbushjes së këtyre objektivave:

A1.. Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës së Ndhmës Ekonomike  
Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës të Ndhmës Ekonomike, do të realizohet nëpërmjet: i) ndjekjes së zbatimit në nivel kombëtar i skemës dhe dinamikës së Ndhmës Ekonomike të reformuar; ii) Vlerësimit të ndikimit të skemës së NE dhe formulës së pikëzimit në nivel kombëtar; iii) Plotësimit të kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit “Për asistencën sociale në RSH”; iv) Monitorimit financiar të përdorimit të fondit 6% nga ana e NJQV.

Tregues të suksesit të këtij objektivi do të jenë *konsolidimi* i skemës së re të NE në nivel kombëtar dhe konsolidimi i kriterëve të përfitimit në nivel kombëtar duke rritur transparencën e skemës.

Gjithashtu tregues të suksesit të këtij objektivi do të jenë *konsolidimi* i skemës së re të NE në nivel kombëtar dhe konsolidimi i kriterëve të përfitimit në nivel kombëtar, duke rritur transparencën e skemës.

Në kuadër të këtij objektivi do të synohet edhe nxitja e arsimimit dhe vaksinimit të gjithë fëmijëve përfitues të programit të Ndhmës Ekonomike përmes masave nxitëse progresive. MSHMS-ja do të nxisë qeveritë vendore dhe rajonale për identifikimin e masave praktike në

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1071, datë 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2015-2020”.

mbështetje të familjeve dhe individëve përfitues të Ndhmës Ekonomike, duke garantuar qasje më të mirë të tyre ndaj arsimit të fëmijëve dhe shërbimeve shëndetësore.

Programi i daljes dhe ndërthurja me programet e nxitjes së punësimit përbën një tjetër risi, duke lehtësuar procesin e integritit të familjeve dhe individëve të saj drejt tregut të punës. Plotësimi i kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit "Për asistencën sociale në RSH" do të përfshijë hartimin, konsultimin e akteve nënligjore, ndjekjen e procedurave për miratim në KM sipas procedurave përkatëse (përfshirë edhe praktikën e përfitimit të ndihmës në natyrë),

Për informimin e komunitetit dhe grupeve të interesit mbi plotësimin e kuadrit nënligjor do të organizohen takime të ndryshme në nivel vendor dhe rajonal.

Një vëmendje më të shtuar strategjia i kushton monitorimit financiar të përdorimit të fondit 6% nga ana e NJQV duke përgatitur raporte analitike mbi procedurën e aplikimit, vlerësimin dhe përfitimit të ndihmës nga ky fond.

Zhvillimi i një studimi vlerësues mbi ndërthurjen e programit të NE me programe të tjera mbështetëse, do të shërbejë për llogaritjen e masës reale të përfitimeve, që familjet përfitojnë realisht nga të gjitha programet e tjera mbështetëse do të prezantojnë për herë të parë mbështetjen reale që shteti u ofron familjeve përfituese të skemës së NE (përfitimet nga skema e NE, bonueset e bebes, bonuset e qerasë, bursat për të rinjtë që vazhdojnë shkollën e mesme/ të lartë, ndihmat humanitare etj)

Gjithashtu hartimi i një raport vlerësimi (studimi) mbi ndikimin e masës së ndihmës ekonomike në përmirësimin e cilësisë së jetesës së familjeve përfituese nga skema e NE do të nxisë Ministrinë dhe qeveritë vendore dhe rajonale për identifikimin e masave praktike në mbështetje të familjeve dhe individëve përfitues të Ndhmës Ekonomike, duke garantuar qasje më të mirë të tyre ndaj skemave mbështetëse.

**A2. Konsolidimi i skemës së Ndhmës Ekonomike me anë të mirëadministrimit të regjistrit elektronik kombëtar dhe sistemit të pikëzimit.**

Ky objektivi do të realizohet nëpërmjet kualifikimit të vazhdueshëm të stafit në të gjitha nivelet për të përdorur dhe ushtruar detyrat funksionale me regjistrin elektronik të Ndhmës Ekonomike, si dhe përmirësimin dhe mirëmbajtjes së vazhdueshme të tij.

Regjistri elektronik i Ndhmës Ekonomike do të zhvillohet më tej, me zbatimin/konsolidimin e modulit të kontrollit dhe profilit të riskut, për të zbuluar raste të mundshme abuzimi. Regjistri gjithashtu do të mundësojë monitorimin në kohë reale të skemës dhe do të vlerësojë performancën e saj. Regjistri përfshin module për menaxhimin e integruar dhe një lidhje me sistemin e Thesarit për të mundësuar pagesën e drejtpërdrejtë të individëve dhe familjeve në nevojë. Regjistri do të mundësojë aksesin edhe të institucioneve të tjera sipas rastit.

Modernizimi i skemës është i lidhur me objektivin A1 edhe me realizimin e treguesve lidhur me shenjëstrimin, mbulimin dhe transparencën.

**A3. Rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndhmës Ekonomike.**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1071, datë 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2015-2020".

Do të synohet krijimi dhe rritja e kapaciteteve të strukturave dhe mekanizmave monitorues, vlerësues dhe raportues në të gjitha nivelet. Brenda vitit 2022, institucionet përgjegjëse të skemës së Ndihmës Ekonomike, do të jenë të afta të për administruar, monitoruar dhe vlerësuar procesin, ku një ndër aspektet kryesore do të jetë aftësimi i personelit për instrumentet e reja të skemës së reformuar.

Regjistri elektronik do të mundësojë përmirësimin e sistemit të vlerësimit/monitorimit, raportimit në të gjitha nivelet, ndjekjen e ecurisë së pagesave lidhur me treguesit si dhe përmirësimin e auditit dhe kontrollit për të reduktuar numrin e abuzimeve, nëpërmjet prodhimit të raporteve tremujore të performancës së skemës për politik-bërësit.

Forcimi i kapaciteteve dhe rritja e ndërgjegjësimit të zyrtarëve përgjegjës do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të kontrollit/auditit. Në mënyrë specifike, për zbatimin metodologjisë së kontrollit të NE, mekanizmave standartë të parandalimit dhe zbulimit të mashtrimit në NE, mbi menaxhimin e informacionit dhe mekanizmat e pagesës, në mënyrë që të kenë mundësi të zbulojnë rastet e abuzimit dhe gabimit apo penalitetet sipas rastit.

A4. Transformimi i programit të Ndihmës Ekonomike në skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim nëpërmjet zbatimit të Programit të daljes nga skema e NE.

Transformimi i programit të Ndihmës Ekonomike në skemë integrimi do të realizohet nëpërmjet: i) Zhvillimit të politikave për Programin e Integritit Social ( strategjia e daljes); ii) Nxitjes dhe promovimit të Ndërmarrjeve Sociale; iii) Vlerësimit të impaktit për familjet e skemës së NE nga skema të tjera mbështetëse.

Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Strategjisë së Daljes synon krijimin e lidhjes së qëndrueshme midis skemës së Ndihmës Ekonomike dhe skemave të arsimit profesional dhe programeve të përgatitjes për punësim, ndërmarrjeve sociale, skemave zhvillimore territoriale, me synim fuqizimin dhe aktivizimin e familjes dhe individit. Strategjia e daljes dhe ndërthurja me programet e nxitjes së punësimit përbën një tjetër risi, duke lehtësuar procesin e integritit të familjeve dhe individëve të saj drejt tregut të punës.

Forcimi i kapaciteteve në nivelet përgjegjëse drejt qasjeve që nxisin përfituesit e Ndihmës Ekonomike drejt mundësive për punësim dhe integrim përbën një tjetër tregues për realizimin e këtij objekti.

Hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit për aplikimin për të përfituar statusin e Ndërmarrjes Sociale, sensibilizimi i grupeve të interesit nëpërmjet fushatave informuese mbi risinë "Ndërmarrje Sociale", asistimi i organizatave që kërkojnë të aplikojnë për të fituar statusin e Ndërmarrjeve Sociale, respektimi i kriterit të punësimit të kategorive në nevojë në ndërmarrjet sociale, ngritja e komisionit të vlerësimit të aplikimeve për njohjen e statusit të ndërmarrjes sociale, dhe për procesin, deri në nëshkrimin e kontratave OJF dhe garantimi nga qeveria i kontributit për ndërmarrjet sociale përbën garanci për mirëfunksionimin e ndërmarrjeve sociale.

Vlerësimi i impaktit për familjet skemës së NE nga skema të tjera mbështetëse si: bonuse (për kategori të vecanta dhe fëmijët), përfitime nga shërbimet shoqërore ( publike dhe jopublike), strehimi (qera, banesa sociale), donacione (pagesa për fëmijët jetimë, mbështetje nga

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1071, datë 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2015-2020".

institucionet fetare dhe OJF ) etj, do të realizohet nëpërmjet hartimit të një studim vlerësimi, rekomandimet e të cilit do të shërbejnë për përmirësimin e programeve mbështetëse për familjet në nevojë.

B. *Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara*, nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social, bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në Cash me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Qëllimi "Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara përmes vlerësimit bio-psikosocial, bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke kombinuar skemën e përfitimeve në pagesa me shërbimet e integruara, për të arritur integrimin e tyre social dhe ekonomik"

B.1: Reformimi i sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të realizuar vlerësimin bio-psiko-social duke ulur me 10% rastet abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar deri në vitin 2020, dhe duke reduktuar fondin që shkon për përfitimet në pagesa në masën 27% deri në vitin 2024.

Reformimi i sistemit të vlerësimit përmban këto komponentë (a) rishkrimin e kriterëve për vlerësimin e aftësisë për realizimin e detyrave bazë të jetës në përputhje me moshën, (b) krijimin e një procesi të ri vlerësimi shumëdisiplinor me disa hallka informacioni e pika verifikimi, (c) përdorimin e regjistrit elektronik kombëtar, (d) rishikimin e procesit të ankimimit, (e) përmirësimin e procesit administrativ për të parandaluar e shmangur abuzimin.

Përfituesit përzgjidhen në bazë të kriterëve të rishikuara të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të cilat përfshijnë 2 manuale (një manual për të rritur dhe një manual për fëmijë) që përshkruajnë në mënyrë më të detajuar gjendjet mjekësore që sjellin aftësi të kufizuar, duke mundësuar statistika të hollësishme e të krahasueshme për gjendjen e aftësisë së kufizuar në rang kombëtar dhe përdorimin e sistemit të kodifikimit dhe të cilësorëve të Klasifikimit Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit për të Rritur dhe Fëmijë. Procesit i vlerësimit të aftësisë së kufizuar do të realizohet nga komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Fillimisht komisionet u ngritën në Tiranë dhe gradualisht do të ngrihen dhe funksionojnë në të gjithë territorin e vendit. Ky proces pritet të përfundojë në vitin 2024.

B.2: Ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve referuese, vlerësuese dhe monitoruese dhe koordinimi ndërinstytucional i reformës së sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Do të ngrihen dhe funksionojnë: i) grupi ndërinstytucional i punës për zbatimin e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar, dhe ii) grupi instytucional i miratuar me Urdhër të Ministrit përgjegjës, mbi vlerësimin, monitorimin dhe koordinimin e reformës

Do të synohet fuqizimi i kapaciteteve të strukturave referuese (mjekë familje, specialist), strukturave vlerësuese (komisioneve shumëdisiplinore të vlerësimit dhe ankimimit) dhe mekanizmave monitorues, vlerësues dhe raportues, përmes trajnimeve të vazhdueshme, trajnimeve në vendin e punës dhe trajnimeve on-line përmes SMI-së, me qëllim që të

aftësohen për të realizuar procesin e administrimit, monitorimit dhe vlerësimit. Aspekti kryesor do të jetë aftësimi i personelit për instrumentet e reja të skemës së reformuar.

Do të rriten kapacitetet profesionale të punonjësve që punojnë drejtpërsëdrejti me personat me aftësi të kufizuar, nëpërmjet programeve të edukimit në vazhdim dhe masave të tjera që do të

merren si vijon:

- Zhvillimi i përshkrimeve të punës;
- Vlerësimi i kapaciteteve të stafit ekzistues;
- Zhvillimi i kualifikimeve, duke përfshirë module të akredituara;
- Certifikimi i kualifikimeve, duke përfshirë edhe mundësinë e njohjes së atyre të marra paraprakisht.

Në MSHMS do të ngrihet dhe funksionojë një strukturë (sektor i veçantë) për aftësinë e kufizuar.

### B.3: Vlerësimi i skemës së reformuar të aftësisë së kufizuar.

Vlerësimi i pilotimit të aftësisë së kufizuar do të realizohet përmes një studimi të ecurisë së pilotimit të realizuar në njësitë administrative nr. 6 dhe 7 të Bashkisë Tiranë, i cili do të ndihmojë në testimin e zbatimit të reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas modelit bio-psiko-social dhe do të ndikojë në vendimmarrjen për shtrirjen progresive të skemës së reformuar në nivel kombëtar.

Gjithashtu vlerësime do të realizohen lidhur me ndërthurjen e programeve të sigurimeve shoqërore me ato të mbrojtjes sociale në fushën e aftësisë së kufizuar si dhe anketimin e përfituesve të skemës së reformuar të vlerësimit të aftësisë së kufizuar mbi mënyrën se si ka ndikuar skema e re në përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre si dhe matjen e gjurmimit e gabimeve në përfshirjen dhe përjashtimin nga skema e reformuar.

### B.4: Ndërgjegjësimi i publikut, grupeve të interesit dhe aktorëve të përfshirë në zbatimin e reformës përmes fushatave të komunikimit dhe informimit.

Do të synohet zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere të komunikimit mbi rëndësinë dhe mundësitë e programit të reformuar të aftësisë së kufizuar. Në fushatën e ndërgjegjësimit do të përfshihen edhe referuesit e vlerësuesit e aftësisë së kufizuar, duke përdorur platforma të ndryshme mediatike, si media e shkruar, apo mënyrave të tjera të shpërndarjes së informacionit, për rastet ku individët dhe familjet nuk kanë akses në mediat elektronike apo interneti. Do të përdoren platforma elektronike, ku nëpërmjet internetit do të krijohen portale të posaçme, ose do të përdoren rrjetet sociale me qëllim promovimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Do të realizohen takime me qytetarë, grupe të interesit dhe organizata të shoqërisë civile për të komunikuar vizionin, qëllimin dhe efektet e pritshme të reformës. Do të shpërndahen informacione edhe përmes posterave, broshurave, fletëpalosjeve, spoteve, etj.



B.5. Përmirësimi i kuadrit ligjor të vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar dhe rishikimi i përfitimeve duke kombinuar përfitimet në pagesa me shërbimet e integruara.

Ndryshimet në legjislacionin në fuqi do të realizohen fillimisht përmes amendimit të kuadrit ligjor ekzistues, deri në vitin 2020, për të krijuar hapësirat ligjore për zbatimin e skemës së reformuar dhe paralelisht duke lejuar hapësirat e zbatimit të skemës ekzistuese në qarqet ku nuk do të implementohet kjo reformë, duke bërë kujdes që të mos krijohet mbivendosje në legjislacion.

Paketa e re ligjore për zbatimin e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar që do të zbatohet në rang vendi kur të jetë realizuar shtrirja progresive deri në vitin 2024 do të reflektojë kombinimin e përfitimeve të pagesave me shërbimet e integruara.

### C. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror

Qëllimi: Deri në vitin 2022, çdo person dhe familje shqiptare, siç janë kategoritë në nevojë, do të ketë qasje të barabartë dhe do të përfitojnë nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

#### Objektivat specifikë

C1. Ngritja e një sistemi të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel kombëtar deri në 2022

Objektivi do të realizohet nëpërmjet: i) Mirëpërcaktimit të politikave në lidhje me reformën e programit të shërbimeve të kujdesit shoqëror; ii) Plotësimit të akteve nënligjore që do të hapin rrugën për zbatimin e reformës; iii) Përmirësimit të kuadrit institucional për strukturat përgjegjëse për programin e kujdesit shoqëror; iv) Planeve sociale vendore; v) Hartimit të instrumentave, si pjesë e kuadrit rregullator në ndihmë të autoriteteve rajonale/vendore; vi) Zbatimit të Fondit Social për të mbështetur kujdesin shoqëror përmes shërbimeve të reja dhe novatore; vii) Hartimit të Planit të de-institutionalizimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror; viii) Zbatimit të de-institutionalizimit për drejtuesit e nivelit vendor; ix) Krijimit të një rrjeti të kujdesit alternative; x) Shërbimeve të integruara në nivel vendor, me programe të tjera mbështetëse në shëndetesi, arsim, punësim dhe formim profesional, në përputhje me planet sociale vendore

Sa më sipër synohet të ngrihen sisteme funksionale të integruara të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shëndetësorë në Njësitë e Qeverisjes Vendore. Pranë çdo njësie të qeverisjes vendore do të vijojë procesi i me ngritjes / fuqizimit të Strukturave / Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit për shërbime shoqërore në nivel vendor, të cilat kanë detyrimin ligjor, të hartojnë planet sociale vendore. Tërësia e planeve sociale vendore të zhvilluara në nivel lokal, sipas përcaktimeve të Ligjit të Ri të shërbimeve sociale dhe integrimi i tyre, do të përbëjë bazën për hartimin e hartës së shërbimeve shoqërore në shkallë kombëtare.

Përmirësimi i kuadrit institucional për strukturat përgjegjëse për programimin e kujdesit shoqëror do të fokusohet në forcimin e strukturave përgjegjëse për kujdesin shoqëror në nivel kombëtar dhe rajonal, në monitorimin e ngritjes dhe fuqizimit të strukturave përgjegjëse në

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1071, datë 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2015-2020".

nivel vendor, hartimin e protokolleve të punës dhe ndjekja e zbatimit të tyre, si dhe hartimin e programeve afatgjata për ngritjen e kapaciteteve.

Atualisht, MSHMS ka miratuar Shportën Bazë të Shërbimeve Shoqërore, si dhe ka përfunduar kostimin e tyre. Shporta Bazë e Shërbimeve, e detyrueshme për çdo njësi vendore, do të kërkojë një analizë të detajuar të shërbimeve që ofrohen në territorin e Njësive Vendore. Shporta Bazë e Shërbimeve Shoqërore garanton një standard të unifikuar të shërbimeve shoqërore, që garantojnë mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve, që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Vëmendje do të kushtohet analizës së standardeve ekzistuese të shërbimeve të kujdesit social dhe bazuar në rekomandimet e dala nga analiza do të përmirësohen standartet për shërbimet ekzistuese, si dhe do të hartohen të standarteve të reja për shërbimet e reja.

Në kuadër të këtij objekti do të synohet de-institucionalizimi i shërbimeve të kujdesit rezidencial, transformimin e institucioneve të përkujdesit social rezidencial drejt modeleve të reja alternative me bazë komunitare që synojnë mbështetjen e familjes dhe parandalimin e institucionalizimit.

Plotësimi i kuadri ligjor për zbatimin e Fondit Social nëpërmjet mekanizmave të financimit, vetë financimit dhe mbështetja e NJQV për ti përthithur dhe përfituar nga këto fonde do të garantojnë funksionimin e procesit të de-institucionalizimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Së pari do të kërkojen burime shtesë me kalimin e kohës për të lejuar zhvillimin e shërbimeve të reja. Financimi i shërbimeve të kujdesit social mund të përfshijnë fonde nga buxheti qendror i shtetit, fondet e planifikuara nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat nga pronat dhe aktivitetet e tjera të bashkive, kontributet nga shërbime të kujdesit social të përfituesve, dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga partnerët e zhvillimit, organizata, persona fizikë ose juridikë apo individë.

Miratimi i mekanizmave të financimit të Fondit Social bën të mundur ,që çdo bashki të ngrejë shërbime shoqërore në territor për grupet në nevojë, duke financuar në mënyrë të vazhdueshme tre vitet e para shërbimet e reja të ngritura ( në vitin e parë me 90% të financimit, në vitin e dytë me 60% të financimit dhe në vitin e tretë 30% të financimit).

Shërbimet do të mund të kontrahohen nga organizatat jo-fitimprurëse apo ofrues të tjerë të shërbimeve. Kjo do të zvogëlonte kostot e ngritjes dhe do të lejonte fleksibilitet në ofrimin e shërbimit.

Shporta Bazë e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, në nivel komunitar, kostimi dhe mundësia e prokurorimit të shërbimeve shoqërore, do t'i mundësojë bashkitë që të ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, sipas nevojave dhe do të sigurojë që familjet dhe individët në nevojë të kenë akses të garantuar në shërbime kosto efektive.

Ndërthurja e ofrimit të shërbimeve shoqërore me skema alternative punësimi, do të mundësohet nëpërmjet zhvillimit të dialogut dhe bashkëpunimit midis agjensive dhe aktorëve në nivel vendor për përfshirjen e kategorive në nevojë në skemat e punësimit, formimit profesional dhe ngritjen e ndërmarrjeve sociale.

**C2. Zhvillimi i sistemit të integruar të informacionit në nivel rajonal dhe qendror, për të identifikuar, referuar nevojat për shërbime të përkujdesit shoqëror deri në 2022**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1071, datë 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2015-2020".

Për arritjen e këtij objektivi strategjia parashikon kryerjen e një studimi fizibiliteti mbi sistemet ekzistuese aktuale të informacionit në nivel vendor / rajonal (baza e të dhënave të CPU-ve, baza e të dhënave të dhunës në familje, Romalb, etj.) dhe dhënie e rekomandimeve dhe alternativave të MIS.

Në nivel vendor do të ngrihet dhe funksionojë një strukturë e posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit. Struktura/ Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të rastit janë përgjegjëse për: a) identifikimin e nevojave për shërbime shoqërore; b) vlerësojë nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit; c) hartimin e planit social vendor të kostuar; d) planifikimin e shportës bazë të shërbimeve shoqërore; e) kontraktimin e ofruesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; f) grumbullimin dhe hartimin e informacioneve, statistikave dhe mbajnë regjistrin e përfituesve; g) grumbullimin e informacioneve për rjetet e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë.

Ngritja e kapaciteteve për personelin përgjegjës vendor dhe atë të SHSSH rajonal për përdorimin e sistemit të integruar të informacionit dhe asistimin e NJQV nga SHSSH rajonal do të përmësoj koordinimin midis aktorëve të ndryshëm në nivel lokal dhe qendror si dhe do të mundësoj monitorimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror që ofrohen për kategoritë në nevoj.

E gjithë kjo do t'i shërbejë konsolidimit dhe zhvillimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit dhe i një baze të dhënash të integruara për përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe integrimi i tij me sistemet e tjera të menaxhimit të informacionit për përfituesit e NE, PAK, në të gjitha nivelet

**C3. Ngritja dhe fuqizimi i sistemit të monitorimit dhe inspektimit të cilësisë së shërbimeve sociale në nivel lokal, rajonal dhe qendror deri në vitin 2022.**

Do të analizohet mundësia për riorganizimin e strukturave të reja të inspektimit, duke qartësuar varësinë funksionale, rritjen në numër të burimeve njerëzore. si dhe rritjen e kapaciteteve të këtyre të fundit. Do të synohet përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe inspektimit për rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në nivel vendor, rajonal dhe qendror nëpërmjet zhvillimit të një metodologjie të re të inspektimit. Prioritet përbën forcimi i kapaciteteve profesionale për rritjen e efikasitetit të inspektimeve duke përcaktuar role qartësisht të ndara midis SHSSH dhe Inspektoriatit.

**C4. Profesionalizimi i forcës së punës dhe ofruesve të shërbimeve shoqërore nëpërmjet krijimit të një sistemi të kualifikimit deri në vitin 2022**

Do të rriten kapacitetet profesionale të punonjësve që punojnë drejtpërsëdrejti në shërbimet sociale nëpërmjet kreditimit të edukimit në vazhdimësi.

Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve, që punojnë drejtpërsëdrejti në shërbimet shoqërore, nëpërmjet programeve të edukimit në vazhdim dhe masave të tjera, përfshin:

- Zhvillimin e përshkrimeve të punës;
- Vlerësimin e kapaciteteve të stafit ekzistues;
- Zhvillimin e kualifikimeve, duke përfshirë module në nivel universitar;

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1071, datë 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2015-2020".

- Certifikimin e kualifikimeve, duke përfshirë edhe mundësinë e njohjes së atyre të marra paraprakisht.

Krijimi i Programit të Çertifikimit për profesionistët e shërbimeve të kujdesit shoqëror, ngritja e Bordit të Edukimit të Vazhdueshëm, hartimi i programeve të edukimit dhe monitorimi i tyre përbëjnë garancinë që propozon strategjia për realizimin e objektivit.

C5. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për parandalimin e problemeve sociale dhe adresimin pranë shërbimeve sociale, nëpërmjet fushatave të komunikimit deri në 2022.

Do të synohet zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi rëndësinë dhe mundësitë e programit të mbrojtjes shoqërore. Në fushatën e ndërgjegjësimit do të përfshihen edhe ofruesit e shërbimeve, duke përdorur platforma të ndryshme mediatike, si media e shkruar, apo mënyrave të tjera të shpërndarjes së informacionit, për rastet ku individët dhe familjet nuk kanë akses në mediat elektronike apo interneti. Do të përdoren platforma elektronike, ku nëpërmjet internetit do të krijohen portale të posaçme ose do të përdoren rrjetet sociale me qëllim promovimin e sistemit të shërbimeve shoqërore.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij akti janë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale, Ministria e Brendshme, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi që miraton në parim dokumentin strategjik të mbrojtjes sociale dhe planin e veprimit 2019 – 2022 u hartua nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me asistencë teknike nga UNICEF.

Ky dokument është publikuar për konsultim në faqen zyrtare të internetit të MSHMS-së: [www.shendetesia.gov.al](http://www.shendetesia.gov.al).

Strategji dhe Plani i veprimit 2019-2022 është konsultuar me ekspertë të fushës dhe shoqërisë civile gjatë muajit korrik 2019. Gjithashtu, është konsultuar me donatorët dhe përfaqësues të institucioneve Shtetërore në mbledhjen e Grupit të Manaxhimit të Politikave të Integruara, në 2 gusht 2019.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE  
BUXHETORE

Financimi do të bëhet nga Buxheti i Shtetit për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas parashikimeve buxhetore afatmesme dhe afatgjata në PBA 2019-2021, në programin buxhetor 10430 "Për kujdesin Social".

PROPOZUESI

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE

Ogerta MANASTIRLIU

